

QYTETI SAN BENEDETTO DEL TRONTO

REGJISTRIMI I PERGJITHSHEM I POPULLSISE E I BANESAVE N.15

INFORMATIVA PER TE HUAJT

Duke filluar nga data **9 tetor 2011** do te zhvillohet ne te gjithe territorin kombetar **regjistrimi i 15-te i popullsisë dhe i banesave.**

Midis objektivave kryesore eshte numerimi i popullsisë banuese dhe e pranishme ne territorin italian qe i referohet mesnates midis dites 8 dhe 9 tetor 2011.

Regjistrimi eshte i detyrueshem jo vetem per qytetaret italiane por edhe per qytetaret e huaj dhe per ata qe nuk kane shtetesi me kusht qe te jene banues te rregullt ose te pranishem perkohesisht ne territorin kombetar. **Refuzimi denohet me nje sanksion administrativ i shprehur ne para.**

Per kete arsye, qytetaret e huaj ose ata pa shtetesi banues te rregullt ose te pranishem perkohesisht ne Komunen e San Benedetto del Tronto ne daten 9 Tetor 2011 duhet te plotesojne pyetesorin ne lidhje me regjistrimin dhe ta dorezojne ne Komunen e San Benedetto del Tronto ne nje nga menytrat e mundshme.

Pyetesoret do te shperndahen nga Postat Italiane dhe atje ku eshte e pamundur nga kontrolloret. Nese nuk ju arrijne mund t'i terhiqni ne nje nga qendrat komunale te mbledhjes te shenuara me poshte ne te cilat mund edhe t'ju ndihmojne ,nese keni nevojë, per t'i perpiluar.

Pyetesori duhet perpiluar ne gjuhen italiane por kush ka veshtiresi mund te shikoje edhe shembujt qe ISTAT ka vene ne dispozicion te perkthyer ne 17 gjuhe (gjuha shqipe, arabe, bengaleze, bullgare, kineze, franceze, angleze, maqedone polake, portugeze, rumune, ruse, serbe, singaleze, spanjolle, ukraine, urdu).

Per çdo sqarim mund t'i drejtoheni **numrit jeshil 800 069 701** me **operatore ne gjuhe te ndryshme** qe funksionon te gjitha ditet nga 1 tetori 2011 deri me 29 shkurt 2012 (perveç 25 dhjetorit 2011 e 01 janarit 2012)nga ora 9.00 deri ne oren 19.00 e ne periudhen 09 tetor- 19 nentor 2011 nga ora 8.00 ne oren 22.00. Ghithashtu , mund te shkruani ne adresen e postes elektronike infocens2011@istat.it , mund te kontaktoni nje nga qendrat komunale te mbledhjes te hapura nga 10 tetori 2011 nga e hena deri te premten (nga ora 9.00 deri ne oren 12.00dhe nga ora 15.00 deri ne oren 18.00) dhe te shtunen paradite (nga ora 9.00 deri ne oren 12.00)

Qendra komunale e mbledhjes zona Veri prane zyres administrative te merkatos me shumice te peshkut ne shetitoren C. Colombo, n. 90 –Tel. 338 3829700 E. mail ucczonanord@comunesbt.it ;

Qendra komunale e mbledhjes zona Qender prane Istitutit Muzikor "A. Vivaldi" ne rrugen Giovanni XXXIII- Tel. 388 3829649 E. mail ucczonacentro@comunesbt.it ;

Qendra e mbledhjes komunale zona Jug prane qendres Comitato di Quartiere ne rrugen Mare 218 –Tel. 388 3829645 E. mail ucczonasud@comunesbt.it

Ne qendrat e mbledhjes kontrolloret do t'ju ndihmojne per perpilimin e sakte te pyetesoreve , si per ata te shtypur ne leter dhe per ata elektronik.

Shenime per qytetaret e huaj

Duhet te regjistrohen ne **LISTEN "A"** te pyetesorit te gjithë personat qe e kane venbanimin e zakonshem ne banese

- Qytetaret e vendeve anetare te Bashkimit te Europes qe banojne zakonisht ne banese, edhe nese mungojne ne ditën e Regjistrimit 09 tetor 2011;
- Qytetaret e vendeve jo anetare te Bashkimit te Europes qe e kane vendbanimin e zakonshem ne banese dhe qe kane nje titull te drejte per te qendruar ne Itali, edhe nese mungojne ne ditën e Regjistrimit 09 tetor 2011;

Duhet te regjistrohen ne **LISTEN "B"** te pyetesorit personat qe jane perkohesisht te pranishem:

- Qytetaret e vendeve anetare te Bashkimit te Europes , qytetaret e vendeve jo anetare te Bashkimit te Europes , te pranishem perkohesisht ose rastesisht ne banese me 09 tetor 2011 por qe banojne zakonisht ne nje banese tjeter, ne Komune tjeter ose jashte vendit;
- Qytetaret e vendeve jo anetare te Bashkimit te Europes pa dokument te rregullt qendrimi.

Per qytetaret e vendeve jo anetare te Bashkimit te Europes , perbejne te drejta per qendrim ne Itali:

- lejeqendrimi i vlefshem;
- leja per hyrje ne Itali per arsye pune e per bashkim familjar ;
- kerkesat per ripertesitje te lejeqendrimit ;
- kerkesat per leshimin e lejeqendrimit te pare ;

Personat me dy nenshtetesi , italiane dhe te huaj , konsiderohen italiane e duhet te shenojne qe kane nenshtetesine italiane.

Nese je nje qytetar i huaj me dokument te rregullt qendrimi ,qe banon zakonisht ne Komunen e San Benedetto del Tronto duhet te regjistrohesh ne Listen "A", edhe nese nuk je regjistruar ende ne Gjendjen civile.

Shmangia nga regjistrimi mund te sjelle , per ata qe jane te regjistruar, anulimin nga gjendja civile dhe probleme ne marrjen e nenshtetesisë italiane.

Mos humb te drejtat e tua, merr pjese ne regjistrim!

Mos u druaj! Te gjithë personat qe punojne per regjistrimin jane te detyruar te mbajne sekretin zyrtar dhe te gjitha pergjigjet e dhena mbrohen nga ligji per mbrojtjen e karakterit te rezervuar.